



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Gjuhë C (5)

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 0 leksione / 40 seminare
Viti / Semestri : Viti III ,semestri I
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor pranë Departamenteve të tjera FGJH
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Gjuhë C (5) është një lëndë me detyrim dhe lëndë që aftëson formimin gjuhësor. Lenda ofron aftësinë për të përvetësuar koncepte, njohuri, aftësi të nivelit C 1 në gjuhën italiane. Kjo veprimtari, përfshin fusha të tilla, si: gramatika (fonetika, morfologjia, sintaksa e leksiku; drejtshkrimi, drejtshqiptimi. Lënda përftohet përgjatë kursit semestral akademik. Lënda ofron gjithashtu aftësinë për të komunikuar në gjuhën italiane; për t'u orientuar, kërkuar, përshkruar e dialoguar individualisht; lënda ofron dhe përcjell aftësinë e të qenit krijues, duke debatuar, mbështetur dhe arsyetuar në mënyrë kritike dhe autokritike, aftëson gjithashtu studentet, që të jenë të aftë të kuptojnë zberthejnë dhe përvetësojnë një material të shkruar ose të folur në gjuhën italiane. Lënda italiane, gjuhë C1 përcjell informacion të larmishëm në auditor, që presupozon materiale të shkruara të letrarisë italiane.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të rrisë aftësitë e studentit përsa i përket aftësive të tij të njohjes së gjuhës italiane nga një nivel mesatar në atë mbimesatar. Studenti duhet të jetë i aftë të kryej:
2. Të rrisë diskutime të lira, spontane në lidhje me çështje të ndryshme, që mund të lindin gjatë temave të trajtuara.
- 3.Kërkime pune dhe materiali, jashtë tekstit bazë, që synojnë të perfeksionojnë dhe plotësojnë organizimin e punës.